

ARJAN SHUMELI, LULJETA MINE

**DINAMIKA E ZHVILLIMEVE TË TERMINOLOGJISË SË
FUSHËS SË AGROMEKANIKËS NË GJUHËN SHQIPE DHE
ANGLEZE**

1. Hyrje

Dinamika e zhvillimit të terminologjisë së agromekanikës merr rëndësi të madhe, sepse krahas vështirimit të kësaj terminologjie si sistem tërësor leksikor i dy fushave të dijes, bujqësi dhe mekanikë, shohim nga afër edhe mënyrën e zhvillimeve të kësaj terminologjie, ku spikat *baza autoktone* e saj kryesisht me terma të ardhur qysh nga koha e ilirëve. Agromekanika si fushë dije, e lidhur me dy fushat kryesore, si me fushën e mekanikës ashtu edhe me bujqësinë, motivohet jo vetëm me funksionin e këtyre dy fushave të ndryshme brenda një të tërë, por edhe me *gjenezën e saj*, çka pasqyrohet edhe në leksikun përkatës të fushës.

Në të dyja gjuhët, në shqipe dhe në anglishte, dallojmë një *zhvillim pothuajse të përafërt të termave të thjeshtë për veglat e dorës dhe atyre të tërhequra nga kafshët*. Kalimi nga veglat e dorës tek veglat e krahut dhe tek ato të tërhequra me kafshë përbën një zhvillim universal karakteristik për të gjitha qytetërimet botërore. Këto zhvillime sigurisht çuan në lindjen dhe zhvillimin e terminologjisë së agromekanikës, e cila në varësi të çdo vendi gëzon karakteristikat e veta historike-gjuhësore në lidhje me zhvillimin ekonomik të secilit vend. Por më kryesore është të nënvizohet se ky leksik paraqitet si leksik autokton me bazë të gjerë për të dyja gjuhët, çka ka të bëjë me rëndësinë që merr bujqësia për vetë ekzistencën e shoqërisë. Që në parahistori, ashtu sikurse del nga zbulimet arkeologjike, bujqësia ka qenë një nga degët kryesore të prodhimit shoqëror. Kjo vlen edhe për ilirët e shqiptarët, të cilët kanë pasur një bujqësi të përparuar dhe se ajo ka qenë një mjeshtëri që ata e trashëguan brez pas brezi¹. Bashkë me këtë zhvillim historik ata kanë ruajtur edhe leksikun që qëndron për punimin e tokës dhe proceset e ndryshme mekanike që lidhen me *hedhjen e farës, mbjelljen dhe korrjen* etj.

Nisur nga historia e formimit të këtij leksiku, që përbën realisht terminologjinë e fushës në fjalë, e ngritur sot në sistem homogjen dhe të qëndrueshëm, duhet nënvizuar se, ndonëse për të dyja gjuhët kemi të bëjmë me dy periudha kohore të ndryshme (për terminologjinë angleze -shekullin e 17-të dhe për terminologjinë shqipe -fillimin e shekullit të 20-të), në gjendjen e sotme ai mund të vështrohet si entitet i mëvetësuar, i arritur në të njëjtin

¹ S. Anamali, *Arkeologjia dhe bujqësia*, Tiranë, 1980.

nivel. Kjo do të thotë, se nga ana e zhvillimit secila terminologji paraqitet me veçoritë e veta, si, p.sh., formimi më i gjatë në kohë për terminologjinë angleze (3 shekuj) dhe më i shkurtër (mbi një shekull) për terminologjinë shqipe, çka kushtëzon edhe reflekse të ndryshme në ndërtimin e termave, ku mund të vihet re një diferencim më i madh kuptimor (*konceptor*) i emërtimeve në anglishte, sesa në shqipe. Kështu, p.sh., ajo njësi që në shqip emërton disa objekte, si, p.sh., *gërshërë₁* (krasitëse) dhe *gërshërë₂* (qethëse) në anglishte për secilin objekt ka emërtim të veçantë, çka bën që, ajo që shfaqet si polisemi në shqipe, del si sinonimi relative në anglishte; *gërshërë* (shqip) = 1. *pruners* 2. *shears* 3. *scissors* (anglisht). Megjithatë duhet theksuar se mënyra e formimit dhe e plotësimit të kësaj terminologjie e të njëjtës fushë në të dyja gjuhët si edhe proceset e ngritjes në sistem janë pak a shumë të njëjta, ndonëse mjetet e shprehjes (termat) kanë veçoritë e tyre.

Në këtë punim dinamika e zhvillimit të terminologjisë së agromekanikës në shqipe bëhet në rrafshin përqasës me atë të anglishtes, që ka dallime në procesin e zhvillimit historik të tij, por që qëndron në një nivel të përafërt nga ana e gjendjes së arrirë në kohën e sotme, si pak a shumë i barabartë me të. Kjo përbën interes të veçantë sidomos në fushën e standardizimit të terminologjisë të shqipes në rrafsh ndërgjuhësor dhe kjo krijon mundësinë që standardizimi të vështrohej tutje kufijve të shqipes.

2. Terminologjia e agromekanikës në shqipe

Terminologjia e agromekanikës ka të mishëruar në vetvete në thelb fazat e zhvillimit të leksikut bujqësor dhe të mekanikës qysh nga kohët e lashta deri në ditët e sotme, meqë një varg termash kanë ardhur nga fjalët e zakonshme, që shënonin *procese*, *vegla* etj., Bujqësia në vendin tonë në këtë hark kohor qysh nga lashtësia ka pasur karakter primitiv, ku përdoreshin kryesisht vegla bujqësore të thjeshta, me shkopinj, në majat e të cilave kishte gur stralli ose brirë dreri. Kjo lloj bujqësie është quajtur **bujqësia me shat** (ang. hoe-farming)².

Për sa i takon anës sasiore të leksikut special të bujqësisë, por të pa ngritur ende në nivelin e terminologjisë së fushës së agromekanikës, ky leksik ishte i kufizuar kryesisht në emërtimin e veglave bujqësore të thjeshta të krahut dhe të proceseve dhe si i tillë konsiderohet si leksik special i fazës **paraterminologjike të leksikut të bujqësisë** deri në fillim të shekullit të 20-të, kur bujqësia ende nuk ishte ngritur në nivelin e fushës së dijes. Kjo periudhë karakterizohet nga prania e shumë emërtimeve speciale, por jo si terma të mirëfilltë, që lidhen me një varg fushash të mjeshtërive bujqësore si *punimin e tokës* (parmenda), *bartja me qerre* (qerrja), *mulliri i blojës*, me emërtimet e **pjesëve të tyre**, një pjesë e të cilave janë studiuar dhe evidentuar në fjalorthë etj. Karakteristikë për këtë periudhë është lindja dhe ruajtja e

² History of hoe-farming tek <http://en.wikipedia.org/wiki/Hoe-farming>

termave për veglat e krahut dhe të dorës ku, krahas *parmendës*, përdorëshin edhe vegla të tjera të krahut që pasqyroheshin në leksikun përkatës si: *lopatë, kazmë, bel, dhiqel, drapër, shat* etj.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XX leksiku terminologjik i agromekanikës shënon fazën e re të pasurimit dhe të zhvillimit me leksik, kjo periudhë shënon fazën e lindjes së kësaj terminologjie të ngritur në sistem. Pra kemi një dinamikë të re të krijimit të termave të agromekanikës. Kështu nga *parmenda* e tërhequr me qe, u kalua tek *plugu*, nga *drapri* u kalua tek *makinat korreëse* ose *kositëse*, nga *shati* u kalua tek *makinat prashitëse* apo *kultivatorët* e ndryshëm, çka u pasqyrua në leksikun e gjerë dhe të pasur njëfjalësh dhe togfjalësh: *plug, paraplug, motoplug, plug automatik, lesë e rëndë, lesë me dhëmbë* etj. Kështu, fazat e zhvillimit dhe të evoluimit të terminologjisë në fushën e agromekanikës mund t'i vëmë në marrëdhënie të burimit të parë energjetik, të dorës, të krahut, deri tek veglat moderne me pajisjet përkatëse të shprehura me fjalë speciale dhe fjalët e specializuara (termat) si: *dorë* → *kafshë* (*parmendë, plug*) → *makinë* (*motoplug* → *elektroplug* → *plug automatik*; *dorë* → *mokër* → *cilindër bloje* → *fabrikë bloje* → *mulli bloje*. Periudhat pasuese shënuan fazën e përsosjes së terminologjisë së agromekanikës dhe krijimin e saj si nënsistem me baza të forta brenda sistemit të terminologjisë së bujqësisë dhe mekanikës. Kjo fazë lidhet me krijimin e termave të rinj, kjo kryesisht falë përsosjes së teknikës bujqësore, modernizimit të mekanikës bujqësore ku u kalua nga makineri të thjeshta me një proces në makineri të ndërlikuara dhe të afta për të kryer njëkohësisht disa procese njëkohësisht. Kështu lindën terma si, p.sh., *kombajnë, autokombajnë, trior, grirëse –silazhuese* etj.

Krahas leksikut autoktonë si *lopatë, shat, drapër, kosë, lesë* etj., dhe pasurimit të këtij leksiku me mjetet fjalëformuese të vetë shqipes si *lesë-lesoj-lesim-lesuar; plug-plugoj-plugim-pluguar* etj., në fushën e agromekanikës kanë mundur të depërtojnë, ndonëse jo në masë të gjerë edhe terma të gjuhëve kryesore të vendeve të zhvilluara, në të cilat teknika dhe shkenca patën zhvillime të shumta me motorizimin e teknikës bujqësore. Vend parësor në këtë leksik zënë termat e huazuar nga italishtja. Ndërmjet termave të futur nga italishtja në këtë fushë, pas viteve '20-të të shekullit XX, takohen *trapiantim, trapiantatriçe, patinë, ripuntator, elevator, dozator, kultivator, batitor* etj. Në terminologjinë e agromekanikës në një masë të kufizuar gjejmë edhe terma me burim nga gjuha frënge si p.sh., *avantren, plafon, shasi, volant* etj., apo edhe terma nga gjermanishtja si *demfer, drosel, fllanxhë, grejeder, shtangë*, etj.

Zhvillimet e vrullshme të shkencës dhe të teknikës sidomos të teknologjisë moderne patën ndikimin e vet edhe në fushën e agromekanikës, çka u pasqyrua me futjen e anglicizmave qysh para vitit -90-të. Ndër termat

kryesorë të futur nga anglishtja dallojmë *dragë, separator, dezinfektues, kombajnë, marker, biter (kashtës), heder* etj.

Duke parë zhvillimin e shkencës dhe të teknikës në vendet anglishtfolëse si edhe lindjen e termave përkatës me burim nga anglishtja, në fusha të shumta, vihet re se anglicizmat në këto 20 vitet e fundit nuk kanë gjetur vend në fushën e agromekanikës. Kjo ka ndodhur, sepse zona është e zënë, terminologjia në fushë është stabilizuar dhe anglicizmat sot veprojnë më shumë në fusha të tjera si në informatikë, telemetri, elektronikë, teknologji e eksplorimeve hapësinore, apo edhe në fushën e mjekësisë.

Këtu, do të kishte vlerë të veçantë që klasifikimi i terminologjisë së agromekanikës të jepet si rreth kufizues, brenda të cilit do të identifikohet leksiku terminologjik karakteristik për terminologjinë në fjalë si terminologji e një fushe hibride, çka e bën të nevojshme dhe të domosdoshme paraqitjen e caqeve që e evidentojnë atë si sistem të mëvetësuar terminologjik, që i përgjigjet një sistemi konceptor të një fushe dije me lidhje të qëndrueshme të brendshme koherente në bazë të marrëdhënieve që shprehin konceptet njëri me tjetrin. Në këtë rast do të shfrytëzojmë edhe trajtimin që i kemi bërë leksikut të kësaj fushe, vështruar nga pikëpamja e bazave të krijimit të tij, si sistem i qëndrueshëm dhe homogjen, si entitet i mëvetësuar, sipas tipareve, karakteristikave dhe veçorive të shfaqura në të dyja gjuhët, në shqipe dhe në anglishte. Leksiku i fushës së mekanikës e ndajmë si më poshtë:

1. Leksiku special (i specializuar) që shënon procese, një pjesë e madhe e të cilave ka ardhur nga lashtësia: **mbjellje** / *seeding*, **korrije** / *reaping*, **vjelje** / *harvesting*, një pjesë tjetër shënon procese të reja që lidhen me vetë futjen e veglave e makinave të reja si **kalibrim**, **triorim**, **automatizim** / *adjusting*, **tiroring*, *automatization* etj.

2. Leksiku special (i specializuar), që ndonëse shënon koncepte të ardhura nga lashtësia, bën pjesë në sistemin konceptor të fushës së agromekanikës dhe, si të tilla, shenjat përkatëse mund të cilësohen terma: **bel**, **kazmë**, **gërshërë**, **drapër**, **shat** / *trowel*, *pickaxe*, *pruners*, *sickle*, *hoe* etj.

3. Leksiku që lidhet me emërtime personash që pranohen si pjesë funksionale e makinës që drejtojnë si **traktorist** / *tractor-driver*, **kombajnjer** / *combine-harvester driver* etj.

4. Terma të ardhur nga fusha e mekanikës, që funksionojnë në përbërje të togfjalëshave dhe që shprehin specifikën e fushës së agromekanikës, si fushë hibride si **rrotë e brazdës** / *furrow wheel*, **bosht i marrjes së fuqisë** / *tak-off shaft* etj.

5. Terma të ardhura nga fusha të tjera, ose me një përmbajtje konceptore më të përgjithshme si **apar** / *apparatus*, **sistem**/system, **pjesë** / *part*, të cilët duke hyrë në përbërje të togfjalëshave shprehin konceptet e fushës në fjalë si **apar** / *shirës* / *threshing apparatus*, **pjesë kositëse** / *mowing part*, **kokë korrije** / *header*, **sistem ujitës** / *irrigation system* etj.

6. Terma të ngritur mbi bazën e fjalëve të zakonshme, që shfaqen si rikuptimtësime të tyre, të ngritura në nivel termi ose që vijnë të rikuptimësuar nga terminologji të tjera si **bisht** (*lopate*) / **handle** (*shovel*); **vesh** (*plugu*) / **mouldboard** / *plough*; **krah** (*i makinës*) / *arm of machine*; **gisht** (*prerës*) / *tine* (*cutting device*).

7. Terma që rikuptimësohen brenda fushës së dhënë si **lopatë** / *shovel* (*si vegël*) dhe **lopatë** / *bucket* (*buldozeri*)- **lopatë** / *blade* (*përzierësi*); **krehër** / *rake* (*bari*) dhe *krehër* (*leshi*); **shoshë** / *winnow* (*vegël*) dhe **shoshë** / *sieving apparatus* (*makinë*); **sfurk** / *pitchfork* (*vegël*) dhe **sfurk** / *lifting machine* (*makinë*) etj.

8. Terma të huaja ose ndërkombëtarizma: **trior**, **heder**, **tambur**.

9. Terma të shqipëruar: **përzierës** (për *mikser*); **artisëse** (për *piantatrice*); **shimatës** (për *pluviometër*). Në vijim duhet theksuar se shqipërimi i termave merr rëndësi sepse gjuha pastrohet nga lënda e huaj, ndërsa nga ana tjetër, pasurohet e përsoset më tej në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Sipas A. Duro³ “aftësia e fjalës shqipe për zëvendësimin e fjalës së huaj duhet shikuar jo vetëm si aftësi e strukturës së saj kuptimore për të mbuluar kuptimet e fjalës së huaj, por edhe si mundësi e brumit leksikor dhe e mjeteve fjalëformuese për të krijuar njësi të reja leksikore.

3. Zhvillimi i terminologjisë së agromekanikës në gjuhën angleze

Dihet që në një vend të zhvilluar një fushë e caktuar e dijes hedh bazat e saj e ndikuar fuqishëm nga zhvillimet e shkencës dhe të teknikës, prandaj ajo krijon dhe zhvillon termat përkatës në funksion të emërimit të koncepteve, që lindin si rezultat i krijimit të objekteve dhe dukurive të reja shkencore dhe teknike në fushën përkatëse. Terminologjia e agromekanikës në gjuhën angleze, ndryshe nga ajo shqipe, lindi dhe u zhvillua të paktën 2-3 shekuj para saj. Kjo përkon me vitet 1700, me Revolucionin Industrial në Angli⁴, i nxitur nga ndërtimi i traktorëve të parë me avull⁵, që çuan përpara edhe teknikën në fushën e bujqësisë. Në këtë periudhë kur u krijua plugu i parë punues me një plor të gjerë⁶, i cili solli një varg ndryshimesh në pjesët përbërse të plugut të vjetër prej druri, të cilat u pasqyruan në emërtimet përkatëse. Ky zhvillim në fondin leksikor të këtij mjeti të ri solli edhe terma të tjerë, përveç termit ‘*plough*’ ose ‘*plow*’, kryesisht terma që qëndrojnë për emërtime të pjesëve të plugut si, p.sh., **share** / *plor*, *sharepoint* / *hundëz plori*; **landslide** / *pllaz plugu*, **plough frame** / *trupi i plugut*; **stilt** / *këmbëz e plugut*; **plough bottom** / *trup i plugut*; **mouldboard** / *vesh plugu*; **coulter** / *thikë plugu* etj.

³ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 189.

⁴ *Industrial revolution* tek http://en.wikipedia.org/wiki/Industrial_Revolution

⁵ *Steam Tractor* tek http://en.wikipedia.org/wiki/Traction_engine#Steam_tractor .28US.29

⁶ A. Jones, *A brief history of the plough*-Tillage Product Manager, Kverneland (UK) Ltd. <http://www.ploughmen.co.uk/ploughhistory.htm>

Arritjet e mëdha dhe të menjëhershme teknologjike në vitet 1750-1850, si futja e rrotës, dhe përdorimi i burimeve të reja të energjisë, kryesisht i motorave me avull, si forcë shtytëse dhe lëvizëse, çuan në zhvillime të reja në mekanikën bujqësore, kryesisht në punimin e tokës, kultivimin e saj dhe mbledhjen dhe korrien e drithërave. Kësisoj u krijuan një varg i pasur termash togfjalësh si: **reaping machines** / *makinat korrëse*; **self-raking reaping machines** / *makinat vetë-mbledhëse korrëse*; **wheel plough** / *plug me rrota* etj., të cilat e paraqitnin në sistem informacionin e ri tekniko-shkencor. Kjo shënon fillimet e ngritjes në sistem të terminologjisë së re, të ndërtuar si entitet hibrid mbi bazën e dy fushave të dijes, të bujqësisë dhe të mekanikës. Kjo çoi në krijimin e dy nënfushave të dijes, të lidhura në sistem njëra me tjetrën: njëra me një kuptim më të gjerë “*Agricultural Engineering*” (*Inxhineria bujqësore*) dhe tjetra më të ngushtë “*Farm machinery*” (*Makineri bujqësore*).

Kësisoj terminologjia e agromekanikës, siç e kemi quajtur në punimin tonë, filloi të pasurohej dhe të krijohet si nënsistem i mëvetësuar me karakteristikat kryesore gjuhësore dhe historike të kohës. Më tej në shekullin e 19-të dhe të 20-të u bë i mundur mekanizimi i shpejtë i bujqësisë me futjen e traktorëve dhe të autokombajnave. Futja e këtyre makinerive të reja çoi në krijimin e termave të rinj, sidomos të atyre që vihen në punë me energjinë e lëndëve djegëse dhe atë elektrike. Në këtë periudhë u futën shumë terma që kanë në përbërjen e tyre fjalët ‘**moto**’ dhe ‘**auto**’ si: **motormower** / *autokositëse*; **electric combine harvester** / *autokombajnë elektrike*; **motorplough** / *autoplug*; **motor hoe** / *motofrezues*; **rotary cultivator** / *motokorrëse*. Kjo e përforcoi më tej karakterin sistemor të kësaj terminologjie, sidomos në rrafshin e termformimit.

Por mund të vërehet se në gjuhën angleze nuk kanë depërtuar terma të huaj nga gjuhët e tjera në këtë fushë, meqë objektet e kësaj fushe, **makinat** apo **pjesët** e tyre janë krijuar në këtë vend ku flitet kjo gjuhë, kështu që termat janë formuar me brumin e gjuhës vendase. Kryesisht ato janë formuar me rikuptimësimin e fjalëve vendase ose janë krijuar me brumin e gjuhës amtare (angleze) dhe me mjetet fjalëformuese të saj si *plough*, *harrow* etj. Megjithatë termat e huaj takohen rrallë edhe këtu si, *conveyer*, *cultivator*, *axhicator*, *separator*, *disk*, *piluvimetër*, *heder*, *mikser* etj.

Duke përfunduar, përmes punimit të sjellë në këtë konferencë, ne shohim aspekte të rëndësishme të formimit të kësaj terminologjie, e cila duhet inventarizuar duke krijuar një bankë termash, që mund të shfrytëzohet si nga specialistët e fushës, ashtu dhe nga terminologët që marrin për objekt studimi fusha të ndërmjetme të shkencës dhe teknikës.